

Shabanin dhe Shqipdonin. Ata së bashku me vendasit të tjerë e braktisën fshatin Dashec/Doševac më 20.09.1998, kur forcat serbe e bombarduan fshatin. U strehuan në pyll përkaj fshatit **Kozhicë/Kožica** [**Çiçavicë/Čičavica**]. Shabani e kishte temperaturën e lartë dhe Xhevdeti e ka bartur më 22.09.1998 përmes pyjeve te mjeku në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Ditën tjetër, më **23.09.1998**, forcat serbe e bombarduan fshatin në të cilin ishte strehuar popullata nga Dasheci/Doševac dhe fshatrat përreth. Një cifël e granatës e ka qëlluar Shqipdonin e vogël në djep. Dy-tre minuta më vonë, ai ka dhënë shpirt. Ditën e nesërme, Bedrija me prindërit e kanë varrosur Shqipdonin në varrezat në mëhallën e familje së tyre në fshatin Gradicë/Gradica, ku ai prehet edhe sot.

Burimet: deklarata B.X, FDH-40654; J. Osmani, *Krimet...*, II, 310; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00700, FDH-33284.

Elfije (Ruzhdi) Rexhepi

(1.02.1998, shqiptare nga Preloci/Prelovac, komuna e Skënderajt/Srbica)

Krenar (Nazmi) Rexhepi

(1998, shqiptar nga Vushtrria/Vučitrn)

Krenare (Nazmi) Rexhepi

(1998, shqiptare nga Vushtrria/Vučitrn)

Në mëngjesin e datës **23.09.1998**, vëllezërit Ruzhdiu dhe Nazmiu me bashkëshortet dhe foshnjat e braktisën Prelocin/Prelovac dhe u strehuan në bjeshkën e **Çiçavicës/Čičavica**, në një pyll përmbi fshatin **Krasmiroc/Krasmirovac**. Pas hyrjes së tyre në pyll, forcat serbe e nisën bombardimin. Nga ora 11:00, një predhë ka rëndë dhe ka eksplozuar pranë familjes Rexhepi. Nga eksplozimi i saj i fuqishëm, vajza shtatëmuajshe e Ruzhdiut, Elfije, si dhe fëmijët dymuajsh të Nazmiut, Krenari dhe Krenarja, të cilët ishin binjakë, u hodhën në ajër dhe rënë disa metra larg nga vendi ku ishin. Që të gjitha foshnjat u lënduan rëndë. Elfija ndërroi jetë pas dy orësh. E varrosën në mbrëmje në varrezat e Prelocit/Prelovac. Nazmiu i ka çuar Krenarin dhe Krenaren në spitalin e Vushtrrisë/Vučitrn. Kanë dhënë shpirt pas

tri ditësh. U varrosën më 27.09.1998 në varrezat e Vushtrrisë/Vučitrn.

Burimet: deklarata R.R, FDH-20342; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

Muharrem (Murat) Misimi

(20.05.1935, shqiptar nga Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor në kombinatin e *Trepçës/Trepča*, tetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Xhavit (Haradin) Bislimi

(16.06.1956, shqiptar nga Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Mexhit (Hamit) Bislimi

(15.04.1960, shqiptar nga Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Driton (Shaban) Ibrahim

(20.04.1976, shqiptar nga Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, i papunë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Muharremi, Dritoni dhe kushërinjtë Mexhiti dhe Xhavit kanë qenë në përbërje të shtabit lokal të UÇK-së në Prekazin e Epërm/Gornje Prekaze. E mbanin rojën përreth fshatit. Kur, më 22.09.1998, pjesëtarë të Ushtrisë së Jugosllavisë dhe të policisë i sulmuan forcat e UÇK-së në Prekazin e Epërm/Gornje Prekaze dhe fshatrat përreth, Muharremi, Dritoni, Mexhiti dhe Xhavit gjendeshin në pozicionet e veta. Herën e fundit i kishin parë të gjallë më **23.09.1998** në pyllin e fshatit fqinj të **Mikushnicës/Mikušnica**, gjatë luftimeve me forcat serbe. Në datën 25.09.1998, banorët e fshatit i kanë gjetur në këtë pyll trupat e pajetë të Mexhitit, Xhavitit dhe Dritonit. Gjashtë ditë më vonë, më 1.10.1998, u zbulua edhe trupi i Muharremit. Po atë ditë, që të katër u varrosën në varrezat e Prekazit të Epërm/Gornje Prekaze.

Burimet: deklarata B.M, FDH-31868; deklarata Xh.B, FDH-16636; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.